

# DHOMA E BIZNESIT TË DIASPORËS SHQIPTARE



## REKOMANDIMET E KRYETARIT TË DHOMËS SË BIZNESIT TË DIASPORËS SHQIPTARE NË "KËSHILLIN E INVESTIMEVE"

Kryetari i Dhomës së Biznesit të Diasporës Shqiptare z.Ardian Lekaj, mori pjesë në mbledhjen e radhës të zhvilluar nga Këshilli i Investimeve . Mbledhja kishte në fokus sfidat kryesore dhe rekomandimet për promovimin e investimeve në fushën e agro-përpunimit. Disa nga rekomandimet që z. Lekaj përmendi ishin certifikimi i produkteve për eksport , zëvendësimi i prodhimeve të importit me prodhimet vendase, informim më i gjerë i fermerëve përsa i përket subvencioneve eksistuese apo të reja etj. Në kuadër të kësaj mbledhje, u përgatit dhe u prezantua një studim teknik, i cili përfshin gjithashtu edhe 4 profile investimesh dhe karta teknologjike për t'u përdorur si pikë referimi për tërheqjen e investimeve.

**PËR MË SHUMË INFORMACION KLIKONI:** >>>>



## RAPORTI I GAP: DIASPORA KA NDIKIM SHUMË TË MADH NË EKONOMI

Instituti GAP ka publikuar një raport për ndikimin e Diasporës në ekonominë e Kosovës gjatë pandemisë COVID-19, ku është vlerësuar se roli i Diasporës në ekonominë e vendit vazhdon të jetë tejet i madh. Nga GAP është vlerësuar se shkurtimi i qëndrimit të Diasporës në Kosovë ka pasojë të dukshme në ekonominë e Kosovës dhe i ka ndikuar negativisht në sektorë të ndryshëm të ekonomisë duke filluar nga hoteleria, tregtia etj. “Në mënyrë që të shfrytëzohet potenciali financiar i Diasporës, Kosova duhet: të hartojë politika që nxisin ridestinimin e remitencave drejt investimeve dhe kursimit, duke krijuar platforma investuese”.

**PËR MË SHUMË INFORMACION KLIKONI:** >>>>



## BE: VALA E RE COVID-19 E NDËRPREU DINAMIKËN EKONOMIKE

Vala e dytë e Covid-19 që ka përfshirë të gjithë Europën rrezikon rimëkëmbjen e ekonomisë, konstaton Komisioni Europian në Bruksel. Sipas Komisionerit të BE për Ekonominë, Paolo Gentiloni, vala e dytë e Covid-19 po e rrezikon ekonominë në Europë, pasi “hovi i rimëkëmbjes u ndërpre”, u shpreh ai gjatë prezantimit të prognozës koniunkturale për BE dhe eurozonën. Komisioni Europian kërkoi nga Banka Qendrore Europiane të bëjë gjithçka që është e mundur, për të kompensuar pasojat negative.

**PËR MË SHUMË INFORMACION KLIKONI:** >>>>



## JAVA NË LAJME

DIASPORA SI MUNDËSI PËR EKONOMINË



EKSPORTET “MADE IN ALBANIA”/ TREGJE TË REJA NË SHBA, KINË, ITALI E ARABI SAUDITE



FSHZHD TAKIM VIRTUAL PËR “TË RINJTË SHQIPTARË NË DIASPORË”



## KURSI I KËMBIMIT

MONEDHA	BLERJE	SHITJE
USD	104.50	105.30
EUR	123.40	123.90
CHF	113. <sup>80</sup>	114.80
GBP	136.70	138.10
DKK	16. <sup>25</sup>	16.65